



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2023:136943

Datë: 13.01.2025

Numri i dokumentit: 06704316

P.nr.189/23

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTRRI - Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Agron Maxhuni, në çështjen penale kundër të pandehurit Xh.O. nga fshati ..., komuna e Vushtrrisë, për shkak të veprës penale *Kanosja* nga neni 181 paragrafi 1 të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë - Departamentit të Përgjithshëm PP.II.nr.668/23, të datës 15.06.2023, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor e publik me datë 12.12.2024 në praninë e prokurores së shtetit Vyrtyte Gërvalla, palës së dëmtuar H.J., përfaqësuesi me autorizim i palës së dëmtuar av.Ruzhdi Maloku, të pandehurit Xh.O. dhe mbrojtësit sipas autorizimit av.Kada Bunjaku Përçuku dhe shpalljes së aktgjykimit me datën 12.12.2024, më datë 13.01.2025 nxjerr këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri: Xh.O. nga i ati S..., e ëma Z..., e vajzërisë K..., data e lindjes..., në fshatin ..., komuna e Vushtrrisë, ku edhe tani jeton, me numër personal të identifikimit ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, punon tek autosalloni "S...", i martuar, prind i tre fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, ka të kryer shkollën e mesme, më parë i pa gjykuar.

ËSHTË FAJTOR

SEPSE: Me datën 10.05.2023 rreth orës 13:35 minuta, në fshatin Dolak, komuna e Vushtrrisë, saktësisht para dyerve të shtëpisë së të dëmtuarës H.J., me dashje seriozisht e kanos me fjalë se do ta privoj nga jeta me qëllim të frikësimit, si pasojë e mosmarrëveshjes paraprake lidhur me rrugën e përbashkët, në atë mënyrë që i pandehuri i drejtohet të njëjtës me fjalë kërcënuese "nënë ko me ta q.. tash ko me thirr policinë qe pom qitni gurë në rruge dhe ko me ju zhduk krejt prej ktuhi" veprime këto të cilat tek e dëmtuara kanë shkaktuar ndjenjën e ankthit dhe frikës për jetë,

- Me këtë ka kryer veprën penale *Kanosja* nga neni 181 paragrafi 1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata konform dispozitave të neneve 4, 7, 17, 21, 38, 39, 40, 43, 69, 70, dhe nenit 181 paragrafi 1 të KPRK-së, si dhe nenit 364, 449 të KPPK-së, e

## GJ Y K O N

Të pandehurit: Xh.O. i shqipton DËNIM ME GJOBË në shumen prej pesëqind (500) euro i cili dënim do të ekzekutohet pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Në rast se i akuzuari refuzon ose nuk mund të paguajë këtë dënim me gjobë, atëherë ky dënim me gjobë do të shndërrohet në dënim me burg, duke i caktuar të akuzuarit për çdo njëzetë (20) euro të dënimit me gjobë, nga një (1) ditë burgim.

DETYROHET i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësorë të paguajë shumën prej njëqind (100) Euro dhe në emër të taksës për programin e kompensimit të viktimave të krimit të paguaj shumën njëzet (20) Euro. Të gjitha këto në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

## A r s y e t i m

### *Pjesa hyrëse e aktgjykimit të arsyetuar*

Prokuroria Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm ka paraqitur aktakuzë PP-II.nr.2181/23, të datës 30.01.2024, kundër të pandehurit Xh.O. nga komuna e Vushtrrisë, për shkak të veprës penale *Kanosja* nga neni 181 paragrafi 1 të KPRK-së.

Gjykata me datën 25.10.2023, ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar, në të cilën i pandehuri nuk e ka pranuar fajësinë, e në të cilën i njëjti është udhëzuar për të drejtën e tij për të paraqitur kundërshtimet e provave dhe kërkesën për hedhjen e aktakuzës.

Mbrojtësja sipas autorizimit e të pandehurit Xh.O. av.Kada Bunjaku Përcuku, me datën 27.11.2023 ka paraqitur kërkesën për hedhje të aktakuzës dhe kundërshtimin e provave.

Prokuroria Themelore Mitrovicë, brenda afatit ligjor prej 15 ditëve nuk ka paraqitur përgjigjen kërkesën për hedhje të aktakuzës dhe kundërshtimin e provave.

Gjykata, me aktvendimin P.nr.189/23, të datës 01.03.2024 ka refuzuar si të pabazuar kundërshtimin e provave dhe kërkesën për hedhjen e aktakuzës të paraqitura nga mbrojtësja e të pandehurit, i cili vendim është vërtetuar edhe me aktvendimin e Gjykatës së Apelit me nr.PN.nr.532/2024 të datës 02.04.2024 .

Gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit gjyqësor me datë 12.12.2024, në të cilën seancë kanë prezantuar prokurorja e shtetit Vyrtyte, i pandehuri Xh.O., avokatja mbrojtëse av.Kada Bunjaku Përcuku, pala e dëmtuar H.J. si dhe përfaqësuesi me autorizim i palës së dëmtuar av.Ruzhdi Maloku, në të cilën seancë i pandehuri ka deklaruar se nuk e pranon fajësinë, ndërsa gjykata ka vazhduar me administrimin e provave.

*Pretendimet e palëve gjatë shqyrtimit gjyqësor*

Prokurorja e shtetit Vyrtyte Gërvalla në fjalën hyrëse ka deklaruar se gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor me rastin e administrimit të provave do të vërtetohet përtej dyshimit të bazuar mirë se i pandehuri Xh.O. ka kryer veprën penale Kanosja nga neni 181 par.1 nga KPRK. Kjo do të vërtetohet fillimisht nga dëgjimi i të dëmtuarës në cilësinë e dëshmitares, e cila para gjykatës do të tregoj rrjedhën e ngjarjes në ditën kritike si dhe kanosjen që i është bërë nga i pandehuri ashtu siç përshkruhet në aktakuzë. Kësaj deklarate të palës së dëmtuar i jep fuqi provuese edhe raporti mjekësor i cili gjendet në shkresat e lendes i lëshuar në emër të saj, i cili e provon një fakt e që është frika dhe shqetësimi emocional që e njëjta ka përjetuar në ditën kritike si rezultat i kanosjes nga i pandehuri. Me rastin e dëgjimit dhe dhënies se mbrojtjes se të pandehurit po ashtu do të vërtetohet si fakte të rëndësishme ku të gjitha këto prova së bashku do të vërtetojnë rrethanën kryesore të kësaj çështje penale e që është motivi në kryerjen e kësaj vepre penale nga ana e të pandehurit. Në fund të shqyrtimit gjyqësor pa asnjë mëdyshje do të vërtetohet si i pandehuri e ka kryer këtë vepër penale dhe atë në bazë të provave që do të administrohen e të cilat u elaboruan më lartë.

Ndërsa në fjalën përfundimtare prokurori i shtetit ka deklaruar se gjatë këtij shqyrtimit gjyqësor me provat të cilat janë administruar është vërtetuar në tërësi aktakuza e prokurorisë dhe atë se i pandehuri Xh.O. ka kryer veprën penale Kanosja nga neni 181 par.1 të KPRK-së. Kjo është vërtetuar fillimisht nga deklarata e të dëmtuarës e cila në gjykatë ka treguar për shqetësimin emocional që ka pësuar si rezultat i fjalëve kanosëse këtu të pandehurit, se e njëjta në ditën kritike e ka përjetuar friken dhe shqetësimin vërtetohet edhe në raportin mjekësor i datës 10.05.2023 i lëshuar në emër të dëmtuarës, pra ky raport mjekësor tregon se e njëjta ka marr terapi si rezultat i asaj gjendje dhe si i tillë fakti se e dëmtuara rastin në polici e ka lajmëruar dy ditë pas nuk e zbeh deklarimin e saj për arsye se edhe e posedon raportin mjekësor si dhe qëllimi i saj ka qenë që situata të mos përkeqësohet më shumë në mes të dy familjeve, e kjo ndërlihet edhe me faktin se në mes palëve pra familjes së të pandehurit dhe të dëmtuarës në anën tjetër ekziston një kontest pronësor që nuk kontestohet nga askush prej palëve, e që si i tillë e formon vet motivin e kryerjes së kësaj vepre penale, ku edhe vet mosmarrëveshja që kanë pasur palët në ditën kritike i referohet asaj rruge dhe këtë përsëri nuk e konteston as edhe vet i pandehuri. Sa i përket deklarimit të dëshmitares Z.O., e njëjta pranë kësaj gjykate ka vërtetuar vetëm një fakt dhe atë se nuk e ka dëgjuar bisedën që është zhvilluar nga i pandehuri dhe e dëmtuara dhe si i tille meqenëse nuk e ka dëgjuar nuk duhet falur besimin sepse nuk vërteton asnjë fakt në këtë çështje penale. Me të gjitha këto prova vërtetohet gjendja faktike si në dispozitiv të kësaj aktakuze.

Tutja ka kërkuar nga gjykata që të njëjtin të e shpall fajtor, e me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit të merr parasysh si rrethanë renduese faktin se vepra penale është kryer ndaj një personit i cili për shkak të moshës që e ka në raport me të pandehurin e ka goditur rëndë, ndërsa rrethana të tjera renduese e as lehtësuese lidhur me këtë çështje nuk gjen.

Përfaqësuesi i palës së dëmtuar në fjalën hyrëse ka deklaruar se e përkrah në tersi fjalën hyrëse të prokurorit të shtetit e gjithashtu si pale e dëmtuar ka parashtruar kërkesë pasurore juridike

lidhur me këtë çështje penale. Në fjalën përfundimtare po ashtu ka deklaruar se e përkrah fjalën përfundimtare të prokurorit të shtetit.

Pala e dëmtuar në fjalën hyrëse dhe në atë përfundimtare ka deklaruar se pajtohet në tërësi me deklaratimet e prokurorit të shtetit dhe përfaqësuesit me autorizim.

Mbrojtësja e të pandehurit në fjalën hyrëse ka deklaruar se nga ky shqyrtim gjyqësor pret që i pandehuri do të lirohet nga akuza, sepse përveç provave të propozuara nga prokuroria i propozon gjykatës provat e cekura edhe në kundërshtimin e provave dhe atë dëgjimin e dëshmitares Z.O. – nëna e të akuzuarit, Shqipe Osmani – kunata e të akuzuarit dhe zyrtaret policor që kanë qenë në ditën kritike në vend F.H. me numër të ID-së 11338 dhe H.K. me numër të ID-së 5256, andaj nga ky shqyrtim gjyqësor pret që pas dëgjimit të këtyre dëshmitareve i pandehuri të shpallet i pafajshëm për veprën penale për të cilën akuzohet.

Ndërsa në fjalën përfundimtare ka deklaruar se gjatë shqyrtimit gjyqësor pas administrimit të provave personale dhe materiale nuk është arritur që të vërtetohet fakti vendimtar se i pandehuri i ka thënë fjalët kanosëse ashtu siç përshkruhet në dispozitiv të aktakuzës, pasi që ekziston vetëm një deklaratë e të dëmtuarës e dhënë pas 2 ditësh të rastit të pretenduar edhe pse sikurse të kishte qenë e kanosur dhe të kishte ndjere frike apo ankth nga ndonjë fjale e të pandehurit ajo ka mundur të lajmëroj policinë menjëherë që ishte në vendin e ngjarjes, pastaj ka pasur rast edhe me rastin e kontrollës se bere ne po te njëjtën ditë mirëpo rastin e lajmëron si kanosje tek pas 2 ditëve edhe pse nuk e dimë se me iniciimin e kujt është bere kjo e ndikuar ndoshta nga ndonjë familjar i saj, kjo nga fakti se është e vërtetë se familja e të dëmtuarës dhe familja e të pandehurit e kanë një kontest të hapur pronësor dhe atë kjo ka lindur pasi që familja e të dëmtuarës nuk e ka zbatuar një marrëveshje jashtë gjyqësore që kanë pasur mes vete por familja e të pandehurit në asnjë rast nuk kanë tentuar që këto çështje të i zgjidhin me vetëgjyqësi pasi që çdoherë kanë iniciuar procedurë dhe kanë qenë fillimisht në cilësinë e paditësit apo propozuesit.

E njëjta ka kërkuar nga gjykata lirim të të pandehurit në mungesë të provave dhe në të njëjtën kohë, gjykatës i ka propozuar që të i marrë parasysh vetëm rrethanat lehtësuese sepse nuk ka asnjë rrethanë rënduese në veprimet e tij e gjithashtu ka kundërshtuar pretendimin e prokurores që si rrethanë rënduese të mirret mosha e të dëmtuarës në raport me të pandehurin, pasi që në bazë të dispozitave të KPRK-së, e dëmtuara nuk konsiderohet si viktime e ndjeshme

I pandehuri në fjalën hyrëse dhe atë përfundimtare ka deklaruar se e mbështet fjalën e mbrojtësit të tij.

*Provat që janë administruar në shqyrtim gjyqësor*

Gjykata me rastin e mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor në pajtim me nenin 7 të KPPK-së, saktësisht dhe në mënyrë të plotë vërtetoi faktet që janë të rëndësishme për marrjen e vendimit në pajtim me ligjin, më vëmendje të plotë dhe me përkushtim profesional, dhe me përkujdesje vërtetoi faktet kundër të pandehurit si dhe faktet në favor të tij duke i mundur të pandehurit,

shfrytëzimin e të gjitha fakteve dhe provave që janë në favor të tij, ashtu që gjatë shqyrtimit gjyqësor bëri administrimin e këtyre provave:

### *Provat personale*

- Marrja në pyetje e të dëmtuarës në cilësinë e dëshmitares H.J., në seancën e datës 17.09.2024, e cila duke ju përgjigjur pyetjeve të prokurorit të shtetit ka deklaruar se për këtë rast ka dhënë deklaratë në Policinë e Kosovës me datën 12.05.2023 dhe se qëndron pranë asaj deklaratë dhe se ka një kujtesë të njëjtë si në ditën kur ka ndodhur rasti, duke shtuar se në ditën kritike e njëjta ishte duke dalur nga dyert e oborrit për të shkuar në vizitë tek familja e saj, konkretisht tek djali i vëllaut të saj, kur me automjet ka ardhur tani i pandehuri Xh.O. së bashku me nënën e tij, me një shpejtësi të madhe, duke vozitur vrullshëm dhe është ndalur pranë saj poashtu me një shpejtësi të madhe e pastaj ka dalur nga vetura dhe ka filluar ta shaj të njëjtën, të flas fjalë ofenduese duke i thënë “nënën ta q\*fsha, tash ka me thirr policinë, për arsye se po vendosni gurë, ka me ju zhduk krejt nga këtu”.

E njëjta shton se aty pranë hyrjes së oborrit të së njëjtës ka pasur disa mbeturina të cilat janë krijuar si pasojë e motit me shi që ka qenë atë ditë, dhe janë shpërndarë nga pulat, por që të njëjtat i ka larguar, dhe asesi nuk kanë qenë të vendosura nga ana e tyre. E njëjta shton tutje se ndonëse policia kane ardhur atë ditë pas njoftimit të Xh.t, e njëjta edhe pse ishte shume e shqetësuar sepse ajo nuk kishte bërë asgjë e në të njëjtën kohë ishte ajo e cila ishte kërcënuar, prape se prape nuk i ka njoftuar policinë e as që e ka pasur për qëllim të ju tregoj as familjarëve të shtëpisë në mënyre që të mos rritet problemi më shumë, pasi që tashme veçse ekziston një kontest pronësor i cili është në procedure gjyqësor lidhur me këtë pronë, për shkak të gjendjes së rënduar shëndetësore dhe përkeqësimit emocional që ka ardhur si rezultat i fjalëve kanosëse dhe kërcënuese nga tani i pandehuri, e njëjta është detyruar të bej kontrole mjekësore dhe rrjedhimisht edhe të tregoj për rastin në familje dhe poashtu të lajmëroj rastin në polici.

- Marrja në pyetje në cilësinë e dëshmitares Z.O. në seancën e datës 12.12.2024, e cila pas njoftimit nga ana e gjyqtarit lidhur lirim të dhënies së dëshmisë konform dispozitave të KPPK-së respektivisht nenit 124 të KPPK-së, ka deklaruar se në ditën kritike e njëjta ka qenë së bashku me të birin e saj Xh.n duke ardhur nga aeroporti, pas një vizite që kishte pasur në shtetin e Gjermanisë, ku me të arritur në fshatin Dolak, diku rreth orës 13:00, para hyrjes përkatësisht kyçjes për në oborrin e shtëpisë, kishin qenë të vendosur disa gurë në rrugë, e më pas djali i saj ka ndal veturën për të i larguar gurët, ku edhe e njëjta ka dal poashtu nga vetura kur Xh. ka lajmëruar policinë për të ardhur. E njëjta shton tutje se pas njoftimit të policisë, ajo me veturë së bashku me djalin e saj kane shkuar në shtëpi e cila shtëpi është diku 100m larg vendit, e më pas Xh. është kthyer prapë të rruga meqë rast ka mbërritur edhe policia. Si përfundim e njëjta shton se nuk ka dëgjuar biseda të tjera në mes të djalit të saj dhe palës së dëmtuar përveq asaj që Xh. e ka thirr policinë të vie tek vendi i ngjarjes për shkak të vendosjes së gurëve.

- Marrja në pyetje e të pandehurit i cili në seancën e datës 12.12.2024 ka deklaruar se, ashtu siç ka deklaruar edhe në polici, me datë 10.05.2023 ka qenë në aeroport për të marrë nënën dhe kur është kthyer nga aeroporti i ka parë disa gurë në rrugë, të cilët i ka fotografuar dhe me pas i ka larguar nga rruga. Më pas ka dalur kojshikja e të njëjtës si, këtu e dëmtuara H.J., e cila e ka kundërshtuar

largimin e gurëve, e ka mallkuar por që i njëjti nuk ka dashur te flas me të dhe vetëm ka thirrur policinë. Pas dërgimit të së ëmës në shtëpinë e cila është diku 100m larg nga vendi i ngjarjes, kane arritur policia, te cilët i njëjti i ka njoftuar se janë udhëzuar nga policia me herët se sa here te keni probleme sa i përket këtyre gurëve, te njoftohet policia dhe te mos bisedoj me askënd. I njëjti mohon te këtë thënë fjale kanosëse ndaj palës ankuese, ndonëse për këtë prone kane mosmarrëveshje dhe kane një kontest pronësor i cili është duke u zhvilluar në gjykatë.

*Provat materiale:*

- Procesverbali i marrjes në pyetje i ankuses H.J. e dhënë në polici, i datës 12.05.2023, e cila ka deklaruar se me datë 10.05.2023 rreth orës 14:00, ka qenë duke dalur nga dyert e oborrit për të shkuar në qytet, kur me automjet ka ardhur personi Xh.O., i cili duke hyrë në rrugën për të cilën kanë një kontest pronësor- përkatësisht është në procedurë të Apelit, është ndal dhe ka dalur nga vetura duke ju drejtuar të dëmtuarës “ nënën ta q\*fsha, tash kam për ta thirrur policinë, për arsye se po më vendosni gurë dhe po kam problem për të kaluar, kam me ju zhduk krejt nga këtu “. Enjjeta shton se policia kane ardhur atë ditë, por që nuk i k informuar për kanosjen që ka pasur, pasi që ka pasur për qëllim të i evitoj problemet që do te mund te rezultonin nga kjo, por për shkak qe gjendjes shendetesore që i është perkqësuar sot e asaj dite e njëjta është detyruar të ju tregoj në shtëpi, duke shtuar se askush nga familjaret nuk e ka detyruar per të dhënë deklaratë dhe pret që i pandehuri te dënohet sepse e ka kërcënuar te njëjtën dhe ka mundur mdaje ta shkel me veture me shpejtësinë qe ka vozitur:

- Procesverbali i marrjes në pyetje për të dyshuarin Xh.O. i dhënë në polici, i datës 12.05.2023, ku i njëjti ka deklaruar se me datën 10.05.2023 ne orën 13:30 minuta, ai se bashku me nënën e tij Zarife, kane dashur te hyjnë tek dyert e shtëpisë së tyre, mirëpo ne rruge kane qenë te vendosur dis agurë, të cilat i njëjti i ka fotografuar, me pas ka zbritur dhe i ka larguar të njëjtit. Sa i përket ankesës së palës së dëmtuar i njëjti shton se nuk ka pasur fjalosje apo fjale kërcënuese ndaj saj, të gjitha janë vetëm shpifje, ai vetëm i ka thënë që do ta thërras policinë për këtë shkak, pasi që nuk është hera e parë që vendosen gurët në rrugë. I njëjti shton se ndonëse pala ankuese ka folur vazhdimisht, ai ka qëndruar ne veture deri sa ka ardhur policia, duke shtuar se po te ekzistonte me te vërtetë nje kercenim ajo do ta informonte policinë atë dite e jo pasi që kane kaluar 2 dite nga koha kur ka ndodhur ngjarja.

- Raporti fillestar i incidentit i datës 12.05.2023, më të cilën është përshkruar se me datë 10.05.2023, në lokacionin Dolak, ka ndodhur një rast për veprën penale Kanosja, ku palë e dëmtuar është H.J.,

- Raporti i shpejte i datës 12.05.2023, në të cilin është përshkruar se vend i incidentit është fshati Dolak komuna e Vushtrrisë, i dyshuar Xh.O., e dëmtuar H.J. si dhe përshkrimi i ditës kritike i datës 10.05.2023.

- Raporti policor i datës 12.05.2023, në të cilin është përshkruar fakti se me datë 10.05.2023, Stacioni Policor në Vushtri-Njësia e Hetimeve janë udhëzuar që të vazhdojnë për

ne fshatin Dolak-Vushtrri, pasi që kishte ndodhur nje mosmarrëveshje, ku gjatë asaj kohe ka ndodhur kansoja, ku si pale ankuese është H.J. ndërsa i dyshuar Xh.O..

- Raporti i oficerit i datës 12.05.2023, në të cilin është përshkruar fakti se me datë 10.05.2023, Stacioni Policor në Vushtrri-Njësia e Hetimeve janë udhëzuar që të vazhdojnë për ne fshatin Dolak-Vushtrri, pasi që kishte ndodhur nje mosmarrëveshje, sa i përket vendosjes se disa gurëve ne rruge, por që pasi nuk kishte ndonjë problem serioz, kane kërkuar nga palët që të janë të kujdesshëm me veprimet e tyre dhe te mos marrin veprime.

- Raporti mjekësor i lëshuar nga Spitali i Sheik Zayed i datës 10.05.2023, ora 19:45, ku është përshkruar se e dëmtuara është ankuar për dhembje gjoksi dhe ka pranuar tretman mjekësor.

Gjetjet e gjykatës lidhur me faktet

#### *Faktet jo kontestuese*

Për gjykatën është fakt jo kontestues se i pandehuri dhe e dëmtuara janë takuar në ditën kritike dhe kanë pasur një mosmarrëveshje lidhur me disa gurë të vendosur në rrugë.

Nuk ishte kontestuese se i pandehuri në ditën kritike ka njoftuar policinë e Kosovës që të vinë në vend të ngjarjes në fshatin ....

Të gjitha këto fakte janë të pohuara edhe nga vetë palët, por edhe gjejnë mbështetje në provat në shkresat e lëndës.

#### *Faktet kontestuese*

Fakt kontestues për gjykatën dhe i domosdoshëm për tu provuar ishte fakti nëse i pandehuri ka përdorur fjalë kanosëse në raport më të dëmtuarën përgjatë komunikimit me të në lidhje me mosmarrëveshjen për vendosjen e gurëve në rrugë që kanë pasur në ditën kritike.

#### *Si i ka vërtetuar gjykata faktet kontestuese*

Meqenëse i pandehuri me rastin e deklarimit lidhur me fajësinë, nuk e ka pranuar fajësinë sipas aktakuzës, gjykata për vërtetimin e faktit kontestues të lartcekur, si element qenësor për përmbushjen e figurës së veprës penale me të cilën ngarkohet i pandehuri, ka zhvilluar procedurën e provave, ku ka administruar këto prova:

#### *Gjendja faktike e vërtetuar nga ana e gjykatës*

Kjo gjykatë konsideron se përtej çdo dyshimi, pas administrimit të provave në shqyrtimin gjyqësor, analizimit të tyre një nga një dhe të gjitha së bashku, si dhe shikimit në shkresat e lëndës vërtetohet kjo gjendje faktike: se i akuzuari me datë, kohë dhe vend si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ka ndërmarrë veprimet inkriminuese për veprën penale me të cilën ngarkohet.

- Nga marrja në pyetje e të dëmtuarës në seancën e shqyrtimit gjyqësor me datën 29.10.2024 gjykata ka vërtetuar faktin se si të njëjtit kishin pasur mosmarrëveshje lidhur me vendosjen e gurëve në rrugën të cilën i pandehuri e shfrytëzon për të hyrë në oborrin e shtëpisë së tij, për të cilën rrugë kane edhe një kontest gjyqësor, ku në ditën kritike përderisa e njëjta kishte dal për të shkuar në vizitë tek familjarët e saj, vie tani i pandehuri me automjet duke vozitur me shpejtësi të madhe dhe ndalet vrullshëm para saj, ku del nga vetura dhe i thotë “nënë ka me ta q\*, tash kam me thirr policinë që po qitni gurë dhe ka me ju zhduk krejt prej ketyhit”, gurë të cilët ishin grumbulluar si pasojë e motit me shi që kishte qenë atë ditë dhe janë shpërndarë nga pulat.

- Nga procesverbali i marrjes në pyetje e të dëmtuarës në polici me datën 12.05.2023 gjykata ka vërtetuar se si i pandehuri i është kanosur ne ditën kritike me datë 10.05.2023 dhe si pasojë e përkeqësimit shëndetësor e njëjta është detyruar që po atë ditë të merr trajtim mjekësor .

- Nga raporti mjekësor i përpiluar nga Qendra Emergjente-Spitali Sheikh Zayed, i datës 10.05.2023, gjykata ka vërtetuar se e dëmtuara ka shkuar në kontrollë mjekësore për shkak të përkeqësimit të gjendjes shëndetësore si rezultat i fjalëve kanosëse ku e njëjta ka marr edhe trajtim mjekësor.

- Në foton e cila gjendet në shkresat e lëndës, ku shihet rruga dhe vetura ngjyrë hiri e mbylltë, me nr. Targave 02-691-FP, ku shihet edhe në pjesën e djathtë të saj zhavorr- gur të vendosur në rrugë..

#### *Vlerësimi sipas ligjit i provave nga ana e gjykatës*

Gjykata shqyrtoj me vëmendje të gjitha provat e administruara në shqyrtim gjyqësor dhe atyre që gjenden në shkresat e lëndës dhe provave të cilat shfaqin lidhshmërinë e plotë të të pandehurit me veprën penale të kryer u fali besim të plotë, pasi që të njëjtat janë marrë në procedurë të rregullt ligjore.

Gjykata i'a fali në tërësi besimin deklarimit së palës së dëmtuar në seancën e shqyrtimit kryesor, pasi që deklarimi i saj ishte konsistent, i plotë dhe në harmoni edhe me deklarimin e dhënë në polici si dhe me provat që gjenden në shkresat e lëndës, duke qenë se e dëmtuara ka përshkruar në tërësi dhe në mënyrë të plotë rrjedhën e ngjarjes në natën kritike.

Gjykata në tërësi i'a fali besimin raportit mjekësor duke qenë se i njëjti është përpiluar në mënyrë profesionale nga personat përgjegjës, andaj janë të besueshme, të ligjshme dhe me vlerë provuese, pasi që, janë lëshuar nga organet kompetente mjekësore, janë të protokolluara dhe të vulosura.

Gjykata vlerësoi edhe mbrojtjen e të pandehurit, ndërsa deklarimit të tij nuk i'a fali besimin pasi që i mbrojtja e tij nuk është besueshme, sepse të gjitha dëshmitë në këtë rast, siç janë, dëshmia e të dëmtuarës dhe provat materiale, vërtetojnë të kundërtën e asaj çka pretendon i pandehuri.



Gjykata ka vlerësuar edhe deklaratën e dëshmitares Z.O., njëherit edhe nëna e të pandehurit, duke i' a falur pjësisht besimin deklaratës së saj, pasi që ky deklaram e vërteton një fakt që të njëjtit janë takuar me palën e dëmtuar në ditën kritike dhe kane pasur mosmarrëveshje ne lidhje me gurët e vendosur në rrugë, por që pjesa e tjetër e dëshmisë ka për qëllim shmangien e përgjegjësisë penale të të pandehurit.

Neni 181 paragrafi 1 i KPRK-së përcakton formën themelore të veprës penale Kanosja, ashtu që theksohet se: *“Kushdo që seriozisht e kanos personin tjetër me fjalë, vepra apo gjeste se do t'i shkaktoj ndonjë të keqe me qëllim të frikësimit ose të shkaktimit të ankthit te personi i tillë, dënohet me gjobë ose me burgim deri në gjashtë (6) muaj.*

Kjo gjykatë, konsideron se përtej çdo dyshimi të bazuar, është vërtetuar plotësisht gjendja faktike, si në dispozitiv të aktgjykimit dhe se në veprimet e të pandehurit, manifestohen të gjitha elementet objektive dhe subjektive të veprës penale Kanosja nga neni 181 par.1 të KPRK-së.

#### *Gjetjet e gjykatës lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit*

Lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, me rastin e shqiptimit të dënimit ndaj të pandehurit, bazuar në nenin 69, 70 të KPRK-së, duke vlerësuar rrethanat lehtësuese dhe rënduese, kjo gjykatë si rrethana lehtësuese ka vlerësuar faktin se i njëjti nuk ka qenë më parë i dënuar dhe se është familjar baba i tre fëmijëve dhe mbajtës i familjes, ndërsa si rrethanë rënduese gjykata ka vlerësuar faktin se e dëmtuara ka qenë e moshës femër dhe si dhe dëmin e shkaktuar ndaj të njëjtës respektivisht shqetësimin e përjetuar si rezultat i kësaj veprë penale.

Duke vlerësuar të gjitha rrethanat e përshkruara më sipër gjykata të akuzuarin e gjykoi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke gjetur se dënimi me gjobë në shumë prej pesëqind (500) euro është dënim adekuat me shkallen e rrezikshmërisë se veprës penale, shkallen e përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe pasojave të shkaktuara si dhe se me këtë dënim ndaj tij do të arrihet qëllimi i dënimit si në nenin 38 të KPRK-së. Duke i pasur parasysh të gjitha këto nuk ka pasur vend që të pandehurit t'i shqiptohet dënim me i butë ose me i rëndë.

#### *Propozimet e palëve që nuk janë aprovuar nga gjykata*

Mbrojtësja e të pandehurit i ka propozuar gjykatës që në cilësinë e dëshmitarit të dëgjohen zyrtarët policorë që kane qenë ne vendin e ngjarjes.

Gjykata këtë propozim e ka refuzuar për faktin se në shkresat e lëndës janë raportet zyrtare të cilat janë përpiluar nga personat përgjegjës dhe i janë dorëzuar gjykatës nga prokuroria, e po ashtu të njëjtit nuk kanë qenë prezent ne vendin e ngjarjes ku ka ndodhur kanosja, andaj nuk kontribuojnë në zbardhjen e gjendjes faktike por vetëm në zvarritjen e saj.

#### *Arsyet lidhur me vendimin për shpenzimet e procedurës dhe kërkesën pasurore juridike.*

Vendimin mbi kërkesën pasurore juridike gjykata e mori në bazë të nenit 462 par.2 të KPP-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale gjykata e morri në bazë të nenit 449 par.2 nën par.2.6 dhe nenit 452 par.1 të KPPRK-së.

Vendimin për taksën e kompensimit të viktimave të krimit gjykata e morri në bazë të nenit 36 par.3 pika 3.1 të Ligjit nr. 08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Nga çka u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE MITROVICË-DEGA VUSHTRRI  
Departamenti i përgjithshëm-Divizioni penal,  
P.nr.189/23, datë 13.01.2025

Gjyqtari i vetëm gjykues  
Agron Maxhuni

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 ditësh nga momenti i marrjes së këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit